

## ILIRIA e sheh fitim të arritur suksesin e studentit

Pse ILIRIA është zgjidhja më e mirë? Nuk e themi ne, e thonë faktet.

Një i ri sot e ka fatin që të zgjedh në mes të shumë institucioneve universitare dhe ta bëjë zgjedhjen që ai mendon se është me e mira për të ardhmen e tij. Ka mjaft të atillë të cilët mendojnë se fakti se sot kemi shumë institucione universitare nuk është gjë e dobishme, por parimi themelor i jetës se vetëm të fortit dhe të suksesshmit arrijnë të mbijetojnë vlen edhe në këtë prizëm sepse botërisht është i njohur fakti se konkurrenca e madhe vetëm se e nxit suksesin dhe kualitetin.

Universiteti ILIRIA jo kot e ka marrë thirrjen e nderit universitet mbretëror duke dëshmuar se këtyre viteve Universiteti ILIRIA ka kultivuar vlera të mirëfillta akademike dhe se ka ecur me hapa të sigurt në krijimin e vlerave të veta identifikuese dhe çka është më e rëndësishmja në lindjen e një tradite të re. Komuniteti ILIRIA që përmbledh të gjithë ata që aderojnë në rrethin tonë qoftë si studentë, mësime dhënë apo të tjerë me krenari shënon fillimin e një organizimi të ri për ambientin tonë duke marrë shembull në komunitetet e ngjashme në universitetet prestigjioze botërore.

Cila është vlera themelore që kultivohet në ILIRIA? Studenti dhe sukcesi i tij! Në këtë drejtim ILIRIA nuk kursen duke insistuar fuqishëm që studentët tanë të japin sa më shumë nga vetja dhe që njëherit nesër të jenë në gjendje që të aplikojnë dituritë e tyre. Universiteti mbretëror ILIRIA reflekton traditë, krenari dhe mbi të gjitha siguri. Siguri në investimin e atij që troket në portën e ILIRIA me qëllimin e sinqertë që të krijojë një profil të suksesshëm të studentit.

ILIRIA është institucion privat i arsimit të lartë, por logjika e punës nuk është e organizuar vetëm rreth parimit elementar të biznesit që është fitimi. ILIRIA e sheh fitim të arritur, në radhë të parë, suksesin e studentit dhe për këtë arsye ILIRIA nuk heziton që vazhdimisht të investojë në studentët e vet.